

## RELACION

### PËR

### PROJEKTLIGJIN “PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.25/2024 PËR SIGURINË KIBERNETIKE”

#### **I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN**

Qëllimi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.25/2024 “Për sigurinë kibernetike” është përmirësimi dhe plotësimi i kuadrit ligjor ekzistues në fushën e sigurisë kibernetike, me qëllim rritjen e nivelit të mbrojtjes së infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit, forcimin e kapaciteteve institucionale për reagimin ndaj incidenteve të sigurisë kibernetike, si dhe përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit kombëtar me standardet dhe praktikatat e Bashkimit Evropian.

Në funksion të këtij qëllimi, projektligji synon forcimin e rolit, kompetencave dhe përgjegjësi të Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike në drejtim të koordinimit, mbikëqyrjes dhe reagimit ndaj incidenteve kibernetike, si dhe përmirësimin e organizimit dhe funksionimit të CSIRT-eve sektoriale, duke synuar njëkohësisht forcimin e bashkëpunimit dhe koordinimit ndërinstytucional në nivel kombëtar. Gjithashtu, parashikohet krijimi dhe zbatimi i mekanizmave të rinj të monitorimit dhe vlerësimit të përputhshmërisë, përmes detyrimit të vetëdeklarimit të masave të sigurisë kibernetike dhe raportimit të rregullt nga operatorët e infrastrukturave të informacionit, si dhe rregullimi i procedurave për deklarimin e hostimit dhe administrimin e sistemeve, rrjeteve dhe infrastrukturave të informacionit. Projektligji synon gjithashtu krijimin e Grupit Ndërinstytucional të Inteligjencës Kibernetike me qëllim shkëmbimin e informacionit dhe forcimin e bashkëpunimit strategjik ndërinstytucional si dhe përmirësimi i mekanizmave të kontrollit dhe rritja e efektivitetit të masave administrative dhe sanksioneve në rast të mosrespektimit të detyrimeve ligjore.

#### **II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE**

Projektligji është në përputhje me Programin Politik të Këshillit të Ministrave për transformimin digjital dhe forcimin e sigurisë kibernetike, si dhe me objektivat e Strategjisë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike.

Gjithashtu, projektligji mbështet procesin e integritimit evropian të Republikës së Shqipërisë dhe përafrimin progresiv të legjislacionit kombëtar me *acquis communautaire* në fushën e sigurisë kibernetike.

### **III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Zbatimi i ligjit nr.25/2024 “Për sigurinë kibernetike” ka evidentuar nevojën për disa plotësime dhe saktësime të kuadrit ligjor, me qëllim rritjen e efikasitetit të masave të sigurisë dhe të mekanizmave mbikëqyrës.

Projektligji sjell një sërë risish kryesore në kuadër të forcimit të kuadrit ligjor në fushën e sigurisë kibernetike dhe rritjes së nivelit të mbrojtjes së infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit.

Në radhë të parë, ai përforcon kompetencat e Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike, duke i njohur funksione shtesë në fushën e prokurimeve të përqendruara për trajnimet në sigurinë kibernetike, si dhe në procesin e autorizimit të organeve të vlerësimit të konformitetit në këtë fushë. Gjithashtu, projektligji përmirëson organizimin dhe funksionimin e CSIRT-eve sektoriale, duke forcuar koordinimin ndërmjet strukturave përgjegjëse për menaxhimin e incidenteve të sigurisë kibernetike në nivel sektorial dhe kombëtar.

Një risi tjetër e rëndësishme është krijimi i bazës ligjore për vetëdeklarimin e masave të sigurisë kibernetike nga operatorët e infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit, si një instrument paraprak për monitorimin dhe vlerësimin e përputhshmërisë me kërkesat ligjore.

Projektligji vendos gjithashtu detyrimin për deklarimin e mënyrës së hostimit dhe administrimit të sistemeve, rrjeteve dhe infrastrukturave të informacionit, duke rritur transparencën dhe nivelin e kontrollit mbi infrastrukturën që mbështesin shërbimet kritike.

Në të njëjtën kohë, parashikohet zbatimi i detyrueshëm i masave për bllokimin, filtrimin, kufizimin ose neutralizimin e treguesve të komprometimit (IOC), treguesve të sulmeve (IOA) dhe vulnerabiliteteve të komunikuar nga Autoriteti, me qëllim forcimin e mbrojtjes proaktive ndaj kërcënimeve kibernetike.

Projektligji forcon gjithashtu kuadrin e certifikimit të sigurisë kibernetike, duke përcaktuar procedurat e autorizimit të organeve të vlerësimit të konformitetit dhe duke nxitur përdorimin e produkteve, shërbimeve dhe proceseve TIK të certifikuar, në përputhje me skemat kombëtare dhe evropiane të certifikimit.

Një risi e rëndësishme institucionale është krijimi i Grupit Ndërinstitucional të Inteligjencës Kibernetike, si mekanizëm për shkëmbimin e informacionit, analizën e kërcënimeve dhe forcimin e koordinimit strategjik ndërmjet institucioneve përgjegjëse në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes.

Në përmbyllje, projektligji forcon sistemin e kundërvajtjeve administrative dhe sanksioneve, duke parashikuar shkelje të reja që lidhen me detyrimet e vetëdeklarimit, deklarimin e hostimit dhe moszbatimin e masave të sigurisë të urdhëruara nga Autoriteti, me qëllim rritjen e efektivitetit të zbatimit të ligjit.

Efektet e pritshme të projektligjit konsistojnë në rritjen e nivelit të mbrojtjes së infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit, përmes forcimit të kuadrit rregullator dhe institucional në fushën e sigurisë kibernetike. Gjithashtu, pritet përmirësimi i aftësive parandaluese, monitoruese dhe reaguese ndaj incidenteve të sigurisë kibernetike, si rezultat i qartësimit të

kompetencave dhe rritjes së koordinimit ndërmjet strukturave përgjegjëse. Projektligji sjell gjithashtu rritje të bashkëpunimit ndërinstitucional dhe përmirësim të shkëmbimit të informacionit ndërmjet autoriteteve dhe operatorëve të infrastrukturave të informacionit. Në të njëjtën kohë, parashikohet rritja e nivelit të përputhshmërisë së operatorëve me detyrimet ligjore, përmes mekanizmave të raportimit, vetëdeklarimit dhe mbikëqyrjes. Në tërësi, zbatimi i tij pritet të kontribuojë në forcimin e sigurisë dhe qëndrueshmërisë së shërbimeve publike dhe private që mbështeten në sisteme dhe rrjete të informacionit.

#### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

Projektligji është në harmoni me legjislacionin vendas në fuqi. Gjithashtu, ky projektligj nuk bie në kundërshtim me Kushtetutën dhe me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

#### **V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)**

Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 25/2024 "Për sigurinë kibernetike"" nuk synon përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit kombëtar me *acquis communautaire* dhe nuk përmban dispozita të reja për transpozimin e akteve të Bashkimit Evropian.

Ndryshimet e propozuara kanë karakter organizativ, procedural dhe teknik, me qëllim përmirësimin e kuadrit ekzistues ligjor për sigurinë kibernetike dhe forcimin e mekanizmave institucionale për zbatimin e tij.

Megjithatë, dispozitat e projektligjit janë hartuar në përputhje me parimet, objektivat dhe praktikat më të mira të Bashkimit Evropian në fushën e sigurisë kibernetike, duke ruajtur harmoninë me Direktivën (BE) 2022/2555 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 14 dhjetor 2022, "Mbi masat për një nivel të lartë të përbashkët të sigurisë kibernetike në të gjithë Bashkimin Evropian, duke ndryshuar Rregulloren (BE) nr. 910/2014 dhe Direktivën (BE) 2018/1972, si dhe duke shfuqizuar Direktivën (BE) 2016/1148 (NIS 2)".

#### **VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT**

Projektligji përmban 19 nene, përkatësisht si më poshtë:

Neni 1 parashikon ndryshime dhe shtesa në nenin 5 të ligjit nr. 25/2024 "Për sigurinë kibernetike", duke riformuluar përkufizimin e CSIRT-it sektorial dhe duke shtuar përkufizimin e organit të blerjes së përqendruar për trajnimet në fushën e sigurisë kibernetike.

Neni 2 parashikon ndryshime dhe shtesa në nenin 9 të ligjit, me qëllim përmirësimin dhe zgjerimin e kompetencave të Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike. Konkretisht, bëhet rishikimi i disa kompetencave ekzistuese, forcohet roli i Autoritetit në mbrojtjen e qytetarëve dhe grupeve

vulnerabël në hapësirën kibernetike, si dhe i njihen kompetenca të reja për organizimin dhe kryerjen e prokurimeve të përqendruara për trajnimet në fushën e sigurisë kibernetike për operatorët e infrastrukturave të informacionit të administratës shtetërore, autorizimin e organeve të vlerësimit të konformitetit sipas skemës kombëtare të certifikimit të sigurisë kibernetike, si dhe kryerjen e procedurave të prokurimit publik për pajisje, programe, licenca, platforma dhe sisteme të sigurisë kibernetike në funksion të Autoritetit.

Neni 3 parashikon ndryshime në procedurat e identifikimit të operatorëve të infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit, duke saktësuar detyrimin për dhënien e informacionit dhe periodicitetin e përditësimit të listës së këtyre infrastrukturave.

Neni 4 përmirëson dispozitat që lidhen me kompetencat e CSIRT-it Kombëtar, duke përcaktuar procedurat e simulimit të incidenteve në rrjete dhe sisteme, si dhe bashkëpunimin me institucionet ligjzbatuese për hetimin teknik të incidenteve me elementë të krimit kibernetik.

Neni 5 rregullon organizimin e CSIRT-eve sektoriale, duke përcaktuar institucionet përgjegjëse për ngritjen e tyre.

Neni 6 parashikon ndryshime në detyrat e CSIRT-it sektorial lidhur me njoftimin e incidenteve të sigurisë kibernetike dhe koordinimin me CSIRT-in Kombëtar.

Neni 7 përmirëson detyrimet e operatorëve të infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit, duke parashikuar detyrimin për bashkëpunim me CSIRT-et dhe zbatimin e masave për bllokimin, filtrimin, kufizimin, detektimin ose neutralizimin e treguesve të komprometimit (IOC), treguesve të sulmeve (IOA) dhe vulnerabiliteteve të komunikuara nga Autoriteti.

Neni 8 parashikon nxjerrjen e procedurave dhe kritereve për regjistrimin e organeve të vlerësimit të konformitetit për vlerësimin e masave të sigurisë kibernetike.

Neni 9 shton nenet 20/1 dhe 20/2, duke krijuar bazën ligjore për vetëdeklarimin e masave të sigurisë kibernetike dhe vetëdeklarimin e hostimit dhe administrimit të sistemeve, rrjeteve dhe infrastrukturave të informacionit.

Neni 10 ndryshon dispozitën lidhur me organizimin dhe funksionimin e CERT-it, si dhe mënyrën e shpërblimit të ekspertëve të angazhuar në të.

Neni 11 krijon Grupin Ndërinstitucional të Inteligjencës Kibernetike, përcakton përbërjen e tij, detyrat kryesore dhe mënyrën e organizimit e funksionimit.

Neni 12 ndryshon nenin 39 të ligjit, duke zëvendësuar kriterin e akreditimit me autorizimin nga autoriteti përgjegjës për organet e vlerësimit të konformitetit.

Neni 13 përmirëson dispozitat lidhur me certifikimin e sigurisë kibernetike, duke inkurajuar përdorimin e produkteve, proceseve dhe shërbimeve TIK të certifikuara dhe duke parashikuar miratimin me vendim të Këshillit të Ministrave të listës së operatorëve që duhet të përdorin këto produkte dhe shërbime.

Neni 14 përcakton se procedurat dhe kriteret për autorizimin e organeve të vlerësimit të konformitetit sipas skemës kombëtare të certifikimit të sigurisë kibernetike miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 15 zgjeron rastet e kundërvajtjeve administrative, duke përfshirë mosdhënien e informacionit, mosplotësimin e vetëdeklarimeve, mosdeklarimin e hostimit dhe moszbatimin e masave të sigurisë të komunikuar nga Autoriteti.

Neni 16 përditëson masat e gjobave për kundërvajtjet administrative, duke përcaktuar nivelet përkatëse të sanksioneve sipas llojit të shkeljes.

Neni 17 zgjeron Aneksin I të ligjit, duke përfshirë në sektorin e Administratës Publike edhe subjektet e administratës publike të vetëqeverisjes vendore.

Neni 18 përcakton organet përgjegjëse dhe afatet për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të dispozitave të reja të ligjit.

Neni 19 përcakton hyrjen në fuqi të ligjit.

## **VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E KËTIJ PROJEKTAKTI**

Për zbatimin e këtij ligji ngarkohen Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike, Operatorët e Infrastrukturave Kritike të Informacionit, Operatorët e Infrastrukturave të Rëndësishme të Informacionit, Institucionet rregullatore sipas sektorëve, Operatori qeveritar që menaxhon infrastrukturën qeveritare, Institucionet anëtare të Grupit Ndërinstitucional të Inteligjencës Kibernetike.

## **VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT**

Projektligji është hartuar nga Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (AKSK).

## **IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE**

Zbatimi i këtij projektligji pritet të sjellë efekte financiare në buxhetin e institucioneve përgjegjëse për ngritjen dhe funksionimin e Ekipeve të Përgjigjes ndaj Incidenteve të Sigurisë Kibernetike në nivel sektorial (CSIRT-eve sektoriale), në përputhje me përcaktimet e projektvendimit dhe anekset e ligjit nr. 25/2024 “Për sigurinë kibernetike”.

CSIRT-et sektoriale janë ekipe të përgjigjes ndaj incidenteve të sigurisë kibernetike për sektorin përkatës, të ngritura nga Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike, institucioni përgjegjës për licencimin dhe mbikëqyrjen e bankave, si dhe operatori qeveritar që menaxhon infrastrukturën qeveritare, dhe funksionojnë pranë ministrive përgjegjëse për sektorët përkatës, institucioneve rregullatore për bankat dhe autoriteteve apo operatorit qeveritar që menaxhon infrastrukturën qeveritare, sipas ndarjes sektoriale të përgjegjësisë.

Efektet financiare të këtij projektligji lidhen kryesisht me kostot e personelit të specializuar, si dhe me shpenzimet për ngritjen dhe funksionimin bazë të këtyre strukturave. Përlllogaritja është kryer mbi bazën e strukturës minimale të nevojshme për funksionimin e CSIRT-eve sektoriale, e përbërë nga drejtuesi dhe specialistët e sigurisë kibernetike, në varësi të nivelit të kritikalitetit të sektorëve përkatës.

Në këtë kuadër, efekti financiar i përgjithshëm për funksionimin e CSIRT-eve sektoriale vlerësohet në mënyrë indikative në rreth **350,000,000 – 450,000,000 lekë në vit**, në fazën e plotë të zbatimit të projektligjit.

Për vitin 2026, që përfaqëson fazën fillestare të ngritjes dhe funksionalizimit të strukturave, efekti financiar vlerësohet në rreth **120,000,000 – 150,000,000 lekë në vit**, duke reflektuar vetëm kostot bazë të personelit dhe kapacitetet minimale operacionale të CSIRT-eve sektoriale.

Këto efekte financiare do të përballohen nga buxhetet ekzistuese të institucioneve përgjegjëse, në përputhje me fondet e miratuara dhe planifikimin buxhetor afatmesëm, pa krijuar detyrime për krijimin e institucioneve të reja me personalitet juridik.

Zbatimi i projektligjit do të realizohet me faza, duke mundësuar shpërndarjen graduale të kostove në kohë dhe përshtatjen progresive të kapaciteteve institucionale dhe teknike.